# ORGANI SHQYRTUES I PROKURIMIT

*Sipas Nenit 109 të Ligjit nr. 04/L-042 për Prokurimin Publik të Republikës se Kosovës, i ndryshuar dhe plotësuar me ligjin Nr. 04/L-237, ligjin Nr. 05/L-068 dhe ligjin Nr. 05/L-092*

Një ankesë kundër: **SHSKUK - SHËRBIMI SPITALOR KLINIK UNIVERZITARE I KOSOVËS**

| | |
|---|---|
| **Nr i Prokurimit** | **00220-20-6519-2-2-1** |
| **Nr i brendshëm** | **220-20-089-221** |

Sa i përket tenderit për : **"Mbikqyrja e realizimit te Projektit Ndertimi i Objektit Spitalor për Nënën dhe Fëminën në Prizren "**

# ANKESË

## 1. Identifikimi i ankuesit*

**P.M.N. shpk**
*(Shëno emrin e plotë të kompanisë suaj)*

**Taukbahshqe, Ob. II, Nr. 1/6**
*(Adresa)*

**PRISHTINË** | **10'000**
*(Vendi)* | *(Kodi postar)*

**+383 44 238 511** | **----**
*(Numri Telefonit)* | *(Numri i Faks-it)*

**Zenun Tolaj**
*(Emri i plotë i përfaqësuesit të kompanisë suaj)*

**pmn.shpk@gmail.com**
*(Adresa elektronike)*

**18.02.2021**
*(Data e parashtrimit të kërkesës)* | *(Nënshkrimi dhe vula)*

**Ankues do të thotë një palë e interesuar për parashtrim të ankesës.*

## 2. Identifikimi i avokatit

*Parashtruesi i ankesës mund ta parashtroj ankesën vetëm ose përmes avokatit të tij. Nëse ankesa parashtrohet përmes avokatit, atëherë duhet bashkangjitur autorizimin e përfaqësimit me* PROKURË.
*Shëno të dhënat si në vijim:*

______________________________________________
*(Emri i avokatit)*

______________________________________________
*(Adresa e plotë)*

____________________ ____________________
*(Numri i Telefonit)* *(Numri i faks-it)*

____________________
*(Adresa elektronike)*

____________________ ____________________
*(Data e parashtrimit të ankesës)* *(Nënshkrimi dhe vula)*

## 3. Të dhënat mbi aktivitetin e prokurimit

*[Shëno një përshkrim te shkurtër lidhur me datën dhe vendin në të cilën është publikuar " Njoftimi për Kontratë" apo "Njoftimi për konkurs te projektimit" dhe, nëse aplikohet "Njoftimi për dhënie të Kontratës","Njoftimi për Rezultatet e Konkursit të Projektimit" apo "Njoftimi për anulim te aktivitetit te prokurimit", nëse aplikohet, afatin e fundit për dorëzimin e tenderit, datën dhe orën e fillimit të procesit për Hapjen e Tenderëve, si dhe kriteri për dhënie të kontratës]:*

Ky aktivitet i prokurimit ka te bëjë me tenderin: **"Mbikqyrja e realizimit te Projektit Ndertimi i Objektit Spitalor për Nënën dhe Fëminën në Prizren "**

- *B05 Njoftim për Kontratë (16.10.2020)*
- *Formulari i Korrigjimit (19.10.2020)*
- *Dosja e Tenderit (16.10.2020)*
- *Proceseverbali i hapjes (26.10.2020)*
- *Vendimi i AK i datës (13.11.2020)*
- *Kërkësa për rishqyrtim (16.11.2020)*
- *Vendimi për refuzim të kërkesës për rishqyrtim (18.11.2020)*
- *Vendimi i AK i datës (04.02.2021)*
- *Kërkesa për rishqyrtim (09.02.2021)*
- *Vendimi për refuzim të kërkesës për rishqyrtim (11.02.2021)*

**4. Procesi i Hapjes së tenderëve,** *nëse aplikohet*

*A keni marrë pjesë në procesin e Hapjes së tenderëve? Nëse po, specifikoni shkurtimisht ecurinë e procesit të Hapjes së Tenderëve.*

**Po** [ ] **Jo** [X]

**5. Njoftimi mbi Eliminimin e Tenderuesve,** *nëse aplikohet*

*A jeni njoftuar me shkrim lidhur me eliminimin tuaj nga pjesëmarrja e mëtutjeshme në aktivitetin e prokurimit ?*

**Po** [x] **Jo** [ ]

**6. Zgjidhja preliminare e mosmarrëveshjeve**

*A keni bërë kërkese për rishqyrtim pranë AK lidhur me arsyet e eliminimit tuaj?*

**Po** [x] **Jo** [ ]

*Pas vendimit të parë të Autoritetit Kontraktues, si palë e pakënaqur, kemi bërë kerkesë për rishqyrtim më datë 16.11.2020, pranë AK.*

*Autoriteteti Kontraktues ka refuzuar kërkesën tonë për rishqyrtim, përmës dokumentit - Vendimi për refuzim të kërkesës për rishqyrtim të datës (18.11.2020).*

*Në përputhje me LPP-në dhe brenda afatit ligjor ne i jemi drejtuar OSHP-së me ankesë kundër vendimit të Autoritetit Kontraktues.*

*Me vendimin e panelit të OSHP-së me PSH.NR.1027-20, AK ka rekomanduar që lënda të kthehet në RIVLERËSIM.*

*Pas vendimit përfundimtar të AK, si palë e pakënaqur përsëri kemi bërë kerkesë për rishqyrtim më datë 09.02.2021, pranë Autoritetit Kontraktues.*

*AK ka refuzuar kërkesën tonë për rishqyrtim, përmës dokumentit - Vendimi për refuzim të kërkesës për rishqyrtim të datës* (10.02.2021) .

Në përputhje me LPP-në dhe brenda afatit ligjor ne edhe njëherë i drejtohemi OSHP-së me këtë ankesë kundër vendimit të Autoritetit Kontraktues.

**7. Dispozitat e shkelura nga Autoriteti Kontraktues**

*Specifikoni dispozitën ose dispozitat e LPP-së që supozohet të jenë shkelur nga Autoriteti Kontraktues që nga momenti i publikimit të Njoftimit për Kontratë/Konkurs te Projektimit, dhe nëse aplikohet gjerë në përmbylljen e këtij aktiviteti të prokurimit me publikimin e Njoftimit për Dhënien e Kontratës apo Njoftimit për Rezultatet e Konkursit të Projektimit apo Njoftimit për Anulim.*

**NENI 1 i LPP-së nr.04/L-042 i ndryshuar dhe Amandamentuar*

**NENI 6 i LPP-së nr.04/L-042 i ndryshuar dhe Amandamentuar*

**NENI 7 i LPP-së nr.04/L-042 i ndryshuar dhe Amandamentuar*

**NENI 59 i LPP-së nr.04/L-042 i ndryshuar dhe Amandamentuar*

**NENI 60 i LPP-së nr.04/L-042 i ndryshuar dhe Amandamentuar*

**NENI 69 i LPP-së nr.04/L-042 i ndryshuar dhe Amandamentuar*

**NENI 72 i LPP-së nr.04/L-042 i ndryshuar dhe Amandamentuar*

*** Sipas Nenit 118 të LPP, OSHP-ja do të kthej tarifën tuaj nëse ankesa aprovohet si e bazuar. OSHP-ja mund të kërkoj një gjobë shtesë deri në 5,000 Euro në rastet kur OSHP-ja konstaton që të gjitha apo cilado nga pretendimet e parashtruara në ankesë kane qenë te rrejshme ose mashtruese.*

**8. Deklaratë detale mbi faktet dhe argumentet**

*Përshkruani rrethanat faktike që përbëjnë supozimin për shkeljen e dispozitave të LPP-së. Ofroni deklaratë të qartë dhe të detajuar për faktet dhe argumentet të cilat mbështesin secilën bazë të ankesës tuaj.*

Pas vendimit të OSHP-së, lënda PSH. Nr. 1027-20, dhe rivlerësimit nga AK na dërgohet – B42 Letër standarde për tenderuesin e eliminuar e datës 04.02.2021, po në të njejtën datë e publikuar në platformën e prokurimit publik së bashku me B58 – Njoftim mbi vendimin e AK, ku ngjashëm sikur herën e parë AK shpërblen me kontratë Grupin e operatorëve ekonomik: NORTH-WEST shpk & INFRAPLUS shpk.

**Më datë (26.01.2021) AK ka kërkuar nga kompania jonë informata shtesë në disa kërkesa duke u bazuar ne rekomandimet e OSHP-së, të cilat ne i kemi dorëzuar brenda afatit kohor.** Te njejtat jane te bashkangjitura tek dokumentet percjellese
6.1 Dokumentet e dorezuara ne AK pas kerkeses per info shtese

Autoriteti Kontraktues ka bërë shkeljet e dispozitave nga pika e mësipërme (Pika 7.) të cilat po i elaborojmë në vazhdim. Autoriteti Kontraktues neve si kompani na ka eleminuar përsëri padrejtësisht ku në letrën standarde na ka shpallur si tenderues të eliminuar duke cekur se:

**Pretendimi nr.1 .**

*ARSYETIM*
*Ju jeni eliminuar për këto arsye :*
Kërkesat mbi mundësitë teknike dhe/ose profesionale 9.1 & 9.2
Autoriteti kontraktues i SHSKUK-së ka zbatuar Vendimin e panelit shqyrtues të OSHP-së me nr.prot.1027/20 të datës 28.12.2020 duke respektuar nenin 72 të LPP-së. AK duke u bazuar në nenin 72 të LPP-së nëpër mjetë letrës standarde për sqarim të dosjes së tenderit ka kërkuar informacion shtesë nga OE ofertues, por i njëjti ka bashkangjitur projektet që për AK sipas DT dhe Njoftimit për kontratë nuk janë ndërtime të objekteve spitalore.

AK pretendon se nuk kemi ofruar dëshmi për përfundim të projekteve të ngjashme në fushën e “Ndërtimeve të objekteve spitalore” - Ia bëjmë me dije AK se ky tender ka titullin: [Mbikqyrja e realizimit te Projektit ....] dhe se në dosje të tenderit nuk kërkohet ndërtim i objekteve spitalore, por mbikëqyrje e tyre. [**1.2 Mbikëqyrje të punimeve minimum 1 referencëe mbikëqyrjes të ndërtimit të objekteve spitalore.**]

Më poshtë e keni të bashkangjitur, LISTËN E OBJEKTEVE SPITALORE TË MBIKËQYRA SË BASHKU ME KONTRATAT DHE REFERENCAT e lëshuara nga Autoritetet kontraktuese.

**Pretendimi nr.2 .**

PRETENDIMI 2

Nuk keni ofruar dëshmi siç është kërkuar në Dosje të Tenderit si më poshtë"
Kërkesa -2. Operatori ekonomik ose grupi i Operatoreve Ekonomik duhet të ofrojë dëshmi së ka përfunduar me sukses projekte në fushën e projektimit dhe mbikëqyrjes në tre vitet e fundit minimum 10 projekte në vlerë të gjitha së bashku jo më pak së 70,000.00 Euro. si më poshtë 1.2 Mbikëqyrje të punimeve minimum 1 referencëe mbikëqyrjes të ndërtimit të objekteve spitalore.

PRETENDIMI 3

AK pretendon se nuk kemi ofruar dëshmi për përfundim të projekteve të ngjashme në fushën e projektimit dhe mbikqyrjes në tri vitet e fundit.

**<u>Kërkesa nga AK:</u>**

**Operatori ekonomik ose grupi i Operatoreve Ekonomik duhet të ofrojë dëshmi së ka përfunduar me sukses projekte në fushën e projektimit dhe mbikëqyrjes në tre vitet e fundit minimum 10 projekte në vlerë të gjitha së bashku jo më pak se 70,000.00 Euro.**

**<u>Dëshmitë:</u>**

**Ne si operator ekonomik P.M.N. shpk jemi të specializuar në fushën e mbikqyrjes së projekteve dhe kemi ofruar një listë të projekteve së bashku me kontratat dhe referencat për 15 projekte të realizuara në fushën e mbikqyrjes në total vlerë prej 185,430.97 Euro. Kemi lidhur koncorzium me kompaninë PROing&PARTNERS, të cilët janë të specializuar në fushën e projektimit dhe kemi prezentuar listën prej tri projekteve të tyre me referenca sipas kërkesës nga AK, nga fusha e projektimit – të cilën listë e kemi bashkangjitur në këtë tenderim duke u siguruar se do ta plotësojmë këtë kusht (projektim).**
**Lista nga projektimi (PROing&PARTNERS) kap vlerën prej 174,238.10 Euro.**
**Te dyja listat PMN – Mbikqyrje dhe Proing-Projektim se bashku kapin pesë-fishin e vlerës që AK e kërkon.Te bashkangjitura po ju leme keto lista:**

**Pretendimi nr.3 .**

**<u>Kërkesa nga AK ka qenë:</u>**

**1.2 Mbikëqyrje të punimeve minimum 1 referencë e mbikëqyrjes të ndërtimit të objekteve spitalore.**

**<u>Dëshmia:</u>**

**Ne kemi prezentuar një listë të mbikqyrjeve të objekteve spitalore se bashku me kontrata, e cila përmes referencave (dhe kontratave) dëshmohet përvoja-eksperienca jonë me mbikqyrjen e objekteve spitalore.**

**Kërkesë nga AK – ka qenë minimum një projekt, ne kemi ofruar 5 projekte se bashku me deshmi-referenca per mbikqyrje.**

PMN shpk
Projektim Mbikqyrje Ndërtim

Mbikqyrja e objekteve spitalore - PMN shpk — Data: 23.10.2020

| Nr. | Titulli i Projektit | Nr. Prokurimi | Pranuesi i shërbimeve (Autoriteti Kontraktues) | Fillimi | Mbarimi | Personi kontaktues |
|---|---|---|---|---|---|---|
| 1 | Mbikqyrja e Projektit LOT2 - "Ndërtimi i Ambulancës Specialistike dhe Administrata e QKUK-së" VLERA E KONTRATËS: 9,000.00 EUR | 701-113-079-221 | QKUK - PRISHTINË | 2013 | 2017 | Gazmend Rushiti (Zyrtar përgjegjës i prokurimit) rushiti_29@hotmail.com |
| 2 | Mbikqyrje e punëve shtesë për Projektin "Ndërtimi i Ambulancës Specialistike dhe Administrata e QKUK-së" VLERA E KONTRATËS: 965.00 EUR | 701-17-156-236 | QKUK - PRISHTINË | 2017 | 2018 | Gazmend Rushiti (Zyrtar përgjegjës i prokurimit) rushiti_29@hotmail.com |
| 3 | Mbikqyrje e punëve për Projektin "Ndërrimi i dyerve të sallave të Emergjencës dhe Renovimi i pritores së Emergjencës në QKUK" VLERA E KONTRATËS: 925.00 EUR | 701-18-161-247 | QKUK - PRISHTINË | 2017 | 2018 | Gazmend Rushiti (Zyrtar përgjegjës i prokurimit) rushiti_29@hotmail.com |
| | Mbikqyrja e Investimeve Kapitale - Rahovec VLERA E KONTRATËS: 36,108.00 EUR | 623-18-5814-2-2-1 | KOMUNA E RAHOVECIT | 2018 | 2020 | Jetulla Kabashi (Menaxher i prokurimit) prokurimi.rahovec@hotmail.com |
| 4 | Mbikqyrja e Projektit: NDËRTIMI I QMF - së NË ÇIFLLAK | 623-19-4348-5-2-1 / 623-19-029-5-2-1 | KOMUNA E RAHOVECIT | 2019 | 2020 | Astrit Mullabazi (Menaxher i prokurimit) prokurimi.rahovec@hotmail.com |
| 5 | Mbikqyrja e Projektit: MEREMETIMI DHE LYERJA E OBJEKTIT TË QMF-së NË MALËSI TË VOGËL | 623-20-3911-5-2-1 | KOMUNA E RAHOVECIT | 2020 | 2020 | Astrit Mullabazi (Menaxher i prokurimit) prokurimi.rahovec@hotmail.com |

P.M.N. shpk
Prishtinë

**Referencat:**

Republika e Kosovës
Republika Kosova-Republic of Kosovo
*Qeveria -Vlada-Government*
Shërbimi Spitalor dhe Klinik Universitar i Kosovës
Univerzitetska Bolnička i Klinička Služba Kosova-Hospital and University Clinical Service of Kosovo
*Qendra Klinike Universitare e Kosovës*
*University Clinical Centre of Kosova-Klinički Univerzitetski Centar Kosova*
*Sektori i Prokurimit*

Letër Referencë

Me kërkesë të kompanisë "PMN" shpk - Prishtinë , Qendra Klinike Universitare e Kosovës lëshon këtë letër referencë, me çka vërteton se kompania "PMN" shpk - Prishtinë është shpërblyer me kontartë për: Mbikqyrje e punëve ne Projektin "Ndërtimi i Ambulancës Specialistike dhe Administrata e QKUK-së" "me numër të prokurimit: 701-13-079-221 LOT 2.

Operatori ekonomik me sukses ka perfunduar kontraten ne shumën prej 9,000.00€

Me respekt,
Gazmend Rushiti
E-mail: rushiti_29@hotmail.com
Tel/fax : 038/512666
Datë: 29/07/2019

Republika e Kosovës
Republika Kosova-Republic of Kosovo
*Qeveria -Vlada-Government*
Shërbimi Spitalor dhe Klinik Universitar i Kosovës
Univerzitetska Bolnička i Klinička Služba Kosova-Hospital and University Clinical Service of Kosovo
*Qendra Klinike Universitare e Kosovës*
*University Clinical Centre of Kosova-Klinički Univerzitetski Centar Kosova*
*Sektori i Prokurimit*

Letër Referencë

Me kërkesë të kompanisë "PMN" shpk - Prishtinë , Qendra Klinike Universitare e Kosovës lëshon këtë letër referencë, me çka vërteton se kompania "PMN" shpk - Prishtinë është shpërblyer me kontratë për: Mbikëqyrje **e punëve shtesë** ne Projektin "Ndërtimi i Ambulancës Specialistike dhe Administrata e QKUK-së"Nr. prokurimi: **701-17-156-236.**

Operatori ekonomik me sukses ka përfunduar kontratën ne shumën prej 965.00€

Me respekt,
Gazmend Rushiti
E-mail: rushiti_29@hotmail.com
Tel/fax : 038/512666
Datë: 29/07/2019

**Republika e Kosovës**
Republika Kosova/Republic of Kosova

**Komuna e Rahovecit**
Opština Orahovac /Rahovec Municipality

Datë: 23.10.2020

REPUBLIKA E KOSOVËS
REPUBLIKA KOSOVA
KOMUNA E RAHOVECIT - OPŠTINA ORAHOVAC
Drejtoria për Administratë të përgjithshme
Odeljenje za Opštu Upravu
Nr. i prot. 4346 Më 23.10.2020
RAHOVEC - ORAHOVAC

## REFERENCË

Komuna e Rahovecit lëshon këtë referencë me kryerjen e shërbimeve të mbikqyrjes të projekteve kapitale nga kompania **"F.M.N." shpk** për projektin specifik të mëposhtëm.

Titulli: **"NDËRTIMI I QMF - së NË ÇIFLLAK"**

**Dokumentacioni Juridik:** Kontrata me Numër Prokurimi **623-19-4348-5-2-1** dhe Numër Prokurimi të Brendshëm **623-19-029-5-2-1** e datës 01.08.2019, me vlerë financiare 82,996.59 EUR, dhe Anekskontrata me Numër Prokurimi **623-20-5587-5-3-5** dhe Numër Prokurimi të Brendshëm 623-19-029-5-2-1/5 e dates 01.10.2020 me vlere financiare 8,105.79 Euro.

Gjendja financiare: **Në total për këtë projekt janë realizuar punime në vlerë prej 91,102.38 Euro.**

Autoriteti Kontraktues: **KOMUNA E RAHOVECIT**

Punëkryesi: **" SINANI ING" & "AGE GROUP" shpk**

Kompania **"P.M.N." shpk** ka ofruar shërbimet e mbikqyrjes për këtë projekt sipas detyrave dhe përgjegjësive të kontratës. Ne si autoritet kontraktues ndahemi të kënaqur me shërbimet e ofruara, dhe rekomandojmë kompaninë P.M.N." shpk për projekte-shërbime të natyrës së ngjashme.

Astrit Mullabazi
Komuna e Rahovecit

Rahovec, 23.10.2020

---

**Republika e Kosovës**
Republika Kosova/Republic of Kosova

**Komuna e Rahovecit**
Opština Orahovac /Rahovec Mun cipality

Datë: 23.10.2020

REPUBLIKA E KOSOVËS
REPUBLIKA KOSOVA
KOMUNA E RAHOVECIT - OPŠTINA ORAHOVAC
Drejtoria për Administratë të përgjithshme
Odeljenje za Opštu Upravu
Nr. i prot. 4347 Më 23.10.2020
RAHOVEC - ORAHOVAC

## REFERENCË

Komuna e Rahovecit lëshon këtë referencë me kryerjen e shërbimeve të mbikqyrjes të projekteve kapitale nga kompania **"P.M.N." shpk** për projektin specifik të mëposhtëm.

Titulli: **"MEREMETIMI DHE LYERJA E OBJEKTIT TË QMF-së NË MALËSI TË VOGËL"**

Numri i prokurimit: **623-20-3911-5-2-1**

Vlera e kontratës është: **6,036.30 Euro**

Autoriteti Kontraktues: **KOMUNA E RAHOVECIT - DREJTORIA E SHËNDETËSISË**

Punëkryes : **"ZENA" shpk – Rahovec**

Periudha e implementimit të projektit-kontratës: **Gjate vitit 2020**

Kompania **"P.M.N." shpk** ka ofruar shërbimet e mbikqyrjes për këtë projekt sipas detyrave dhe përgjegjësive të kontratës. Ne si autoritet kontraktues ndahemi të kënaqur me shërbimet e ofruara, dhe rekomandojmë kompaninë P.M.N." shpk për projekte-shërbime të natyrës së ngjashme.

Astrit Mullabazi
Komuna e Rahovecit

Rahovec, 23.10.2020

---

**Republika e Kosovës**
**Republika Kosova-Republic of Kosovo**
*Qeveria -Vlada-Government*
Shërbimi Spitalor dhe Klinik Universitar i Kosovës
Univerzitetska Bolnička i Klinička Služba Kosova-Hospital and University Clinical Service of Kosovo
*Qendra Klinike Universitare e Kosovës*
*University Clinical Centre of Kosova-Klinički Univerzitetski Centar Kosova*
*Sektori i Prokurimit*

## Letër Referencë

Me kërkesë të kompanisë "PMN" shpk - Prishtinë , Qendra Klinike Universitare e Kosovës lëshon këtë letër referencë, me çka vërteton se kompania "PMN" shpk - Prishtinë është shpërblyer me kontratë për: "Ndërrimi i dyerve te sallave te Emergjencës dhe renovimi i Pritores se Emergjencës ne QKUK" – Ritender Nr. prokurimi: **701-18-161-247**

Operatori ekonomik me sukses ka përfunduar kontratën ne shumën prej 925.00€

Me respekt,
Gazmend Rushiti
E-mail: rushiti_29@hotmail.com
Tel/fax : 038/512660
Datë: 29/07/2019

Arsyetimi i AK, pas rishqyrtimit na dërgon:

Në listën të cilën ju e keni prezantuar keni ofruar të dhëna për mbikëqyrje te ndërtimit te Ambulantëve, QMF-ve dhe Renovimit te Emergjencës,**nuk keni ofruar dëshmi për mbikëqyrje të ndërtimit të objekteve spitalore, theksi bie mbi:**

1. **Ndërtim dhe**
2. **Objekte spitalore**

kushte të cilat kontratat e listuara nuk i plotësojnë asnjëra.

**Sqarim:** Sipas Ligjit Nr. 04/L-125 PËR SHËNDETËSI

*-Neni 17 Llojet e institucioneve shëndetësore*

*1. Llojet e institucioneve në sistemin shëndetësor të Republikës së Kosovës janë të njëjta në sektorin: publik, privat, dhe publiko-privat.*

*2. Institucionet e nivelit parësor të kujdesit shëndetësor janë:*

*2.1. **Qendra kryesore e mjekësisë familjare** me njësitë përbërëse të përcaktuara me aktin nën-ligjor të nxjerrë nga Ministria;*

*3. Institucionet e nivelit dytësor të kujdesit shëndetësor janë:*

*3.1. Spitali i përgjithshëm dhe special me njësitë përbërëse të përcaktuara me aktin nën-ligjor të nxjerrë nga Ministria;*

*3.2. Poliklinika specialistike;*

***3.3. Ambulanca specialistike***

*-Neni 19 Kujdesi dytësor shëndetësor 1. Kujdesi dytësor shëndetësor përfshinë: **shërbimet spitalore,shërbimet jashtë-spitalore: diagnostike; terapeutike, rehabilituese, transportin emergjent, si dhe shërbimet e shëndetësisë publike.***

**Elaborim:** Sipas ligjit të sipërcituar Ambulancat Specialistike japin shërbime jashtë-spitalore Shërbimet sekondare shëndetësore ndahen në shërbime Spitalore ku hyjnë Spitalet e përgjithshme edhe jashtë-spitalore ku hyjnë diagnostika, terapeutika, rehabilitimi etj të cilat janë aktivitete që kryhen në Ambulancat Specialistike, rrjedhimisht ndërtesa e Ambulancave Specialistike nuk është Objekt spitalor.

AK ka spjeguar ndarjen e objekteve spitalore, ne baze te funksionimit te tyre dhe sherbimeve qe ata i ofrojne.
Per neve si kompani mbikqyrese ka rendesi vetem aspekti teknik i ndertimit – mbikqyrja e punimeve – sasia dhe cilesia e materialeve qe parashihen me projekt. Nuk ka rendesi ofrimi i sherbimeve qe ofrohet brenda objektit. Të gjitha projektet e prezentuara ne listen tone jane mbikqyrje te objekteve spitalore.
Sqarim: Projekti jonë i ofruar - Ambulanca specialistike në QKUK, QMF në Çifllak, si dhe projektet tjera ne listë – nuk mund të kategorizohen as si objekt shkollore, as qendra tregtare, por fare mirë dihet se janë objekte spitalore.

**Pretendimi nr.4 .[4.1, 4.2, 4.3]**


PRETENDIMI 4.1

Dëshmi - 2. Një Listë të projekteve të realizuara Origjinal e vulosur dhe e nënshkruar nga OE për projekte të përfunduara lista duhet ti ketë këto te dhëna Titullin e kontratës, Investitori,Datën e fillimit të kontratës, Datën e përfundimit të projektit, vlerën e projektit, dhe detyra e kompanisë ( projektim apo mbikëqyrje) .Për çdo projekt qe është shënuar në listë duhet referenca.

Ju si OE ofertues si referncë dhe projekte të përfunduar keni paraqitur:

-Ambulanca specialistike nuk është objekt spitalor sepse nuk ka shtrim dhe as instalime te gazrave medicinal.

-Ndërrimi i dyerve dhe renovimi i pritores se emergjencës nuk është ndërtim

PRETENDIMI 4.3

PRETENDIMI 4.2

**<u>Pretendimi 4.1</u> Autoriteti Kontraktues pretendon se nuk kemi dorëzuar një listë origjinale të vulosur dhe nënshkruar projekteve të realizuara.**

**<u>Dëshmia 4.1</u>**
**Ne më lartë e paraqitem listën tonë P.M.N SHPK (listë e mbikëqyrjeve) dhe të partnerit të koncorziumit PROING&PARTNERS (listë e projektimit) të cilën e kemi përgatitur detajisht me të gjitha të dhnat sipas kërkesës së AK dhe e njëjta ka qenë e dorëzuar ditën e aplikimit. Për secilin projekt në liste kanë qenë të bashkangjitura dëshmitë – kontratat dhe referencat të cilat kanë qenë 100% konform kërkesës së AK.**

**Pretendimi 4.2**
**Autoriteti Kontraktues pretendon se Ambulanca specialistike nuk eshtë objekt spitalor, sepse nuk ka shtrim të gazrave e as instalim të gazrave.**

**Dëshmia nr.4.2**

**I spjegojmë AK se Gazrat janë vetëm një pozicion tjetër në kontratat dhe paramasat e punëve ndërtimore të cilat janë të ngjashme me instalimet tjera në objekt.**
**Në këtë projekt duhet mbikëqyrje e shtrimit dhe instalimit të gazrave, e jo ekzekutim i tyre. Për më tepër në projektin tonë të prezentuar "Lot2 Mbikqyrja e projektit - Ndërtimi i ambulancës specialistike dhe administrata e QKUK" kemi pasur të kontraktuar si pozicion të mbikqyrjes së gazrave – për më qartë po e paraqesim dhe hijëzojmë mëposhtë – pra pozicioni 5 nga e njëjta kontratë, gjë që dëshmon se ne kemi pasë këtë pozicion për mbikqyrje në kontratë dhe se në aspektin teknik-profesional jemi të përgatitur.**

Lot 2: Mbikqyrje te projektit "Ndertimi i ambullantes specialistike dhe administrata e QKUK-se"

| PJESA 2 | | | | | |
|---|---|---|---|---|---|
| NR. I ART. | PËRSHKRIMI | NJËSIA | SASIA | ÇMIMI PËR NJËSI € | TOTALI € |
| 1 | Mbikqyrja e projektit zbatues ne fazën e ndertimit në detaje -(statika me planë të armimit,betonimit,ndertimi,hidroizolimi,detajet e kulmit,të gjitha punët finale zejtare si punët brenda dhe jashtë(në fasadë) objektit dmth të gjitha punët brenda projekti | m2 | 1 | 1.346 | 1.346 |
| 2 | Mbikqyrja e projektit zbatues ne fazën e instalimeve të ujit dhe kanalizimit në detaje dhe të gjitha punët brenda projektit zbatues për këtë fazë. | m2 | 1 | 0.05 | 0.05 |
| 3 | Mbikqyrja e projektit zbatues ne fazën e instalimeve elektrike - rrymës së fortë dhe në detaje dhe kabinave elektrike me gjeneratorë dmth të gjitha punët brenda projektit zbatues për këtë fazë). | m2 | 1 | 0.05 | 0.05 |
| 4 | Mbikqyrja e projektit zbatues ne fazën e instalimeve elektrike -rryma e dobët në detaje dhe të gjitha punët brenda projektit zbatues për këtë fazë (instalimet e internetit dhe telekomunikimit,rrjetit të IT,TV instalimet me antena të përbashkëta,sinjalizi | m2 | 1 | 0.05 | 0.05 |
| 5 | Mbikqyrja e projektit zbatues për gazra medicinale. | m2 | 1 | 0.05 | 0.05 |
| 6 | Mbikqyrja e projektit zbatues për ngrohje qendrore duke I përfshirë edhe nënstacionet - | m2 | 1 | 0.05 | 0.05 |

**Por nëse AK dyshon se ne mund ta mbikqyrim punën e gazrave, ju bëjmë me dije se ju vet keni kërkuar edhe ekspert të gazrave, të cilin e kemi prezentuar.**

**Gjithashtu ju bëjmë me dije se Nuk ka qenë kerkesë e AK në DOSJEN E TENDERIT – objekte spitalore me shtrime dhe instalime te gazrave – por vetëm objekte spitalore.**

**Pretendimi nr.4.3**
**Ndërrimi i dyerve dhe renovimi i pritores se emergjences nuk eshte ndertim**
**Dëshmia nr.4.3**
**Nuk mund ta kuptojmë Autoritetin Kontraktues qartë në këtë pikë, mirëpo do të mundohemi të spjegojmë me aq sa po kuptojmë. Ne si kontratë kemi pasur Mbikqyrjen e punëve për projektin - ndërrimin e dyerve dhe renovimin e pritoreve në emergjencën e vjetër të QKUK-së. Mbikqyrja e këtyre punimeve psh. Renovimit – i cili perfshinë punë më shumë punë sesa nga ndërtimi pasi që fillimisht bëhen demolime me kujdes e më pas ndërtime, e ne të gjitha këto pune i kemi mbikqyrë në projektin për të cilin flitet.**

**Pretendimi nr.5 .**

**Pas qasjes në dokumentacion të kompanisë së shpallur fituese tek pika 1.2 e kerkesave Citojme: 1.2 Mbikëqyrje të punimeve minimum 1 referencë e mbikëqyrjes të ndërtimit të objekteve spitalore.**
**OE i shpallur fitues per projektin " MBIKQYRJA E PROJEKTIT – SPITALI SPECIAL FATI IM" ka dorezuar vetem referencen dhe pasi qe eshte kontrate private nuk e ka te shoqeruar me kontrate dhe transaksion bankar. AK Konform nenit 59.2 dhe 72, eshte dashur te kerkoj sqarime shtese ne lidhje me kete projekt .**

VENDIM

**APROVOHET** SI E BAZUAR ANKESA E OPERATORIT EKONOMIK P.M.N. SHPK lidhur me tenderin **"Mbikqyrja e realizimit te Projektit Ndertimi i Objektit Spitalor për Nënën dhe Fëminën në Prizren"**

**ANULOHET** njoftimi mbi vendimin e Autoritetit Kontrakues: SHSKUK - SHËRBIMI SPITALOR KLINIK UNIVERZITARE I KOSOVËS dhe lënda të kthehet në **Rivlerësim.**
**Autoritetit Kontraktues ti** kërkohet që **rivlerësimin** ta bëjë bazuar plotësisht në kerkesën e dosjes së tenderit që realisht me pas duhej të shpallej fitues koncorsiumi P.M.N. shpk dhe PROing&Partrners shpk.

**9. Dëmet materiale**
*Përshkruaj mënyrën se si shkelja e supozuar i ka shkaktuar ose kërcënohet t'i shkaktojë dëme materiale parashtruesit të ankesës, ne rast se përfshini pretendime për kompensim.*

- *Kompania PMN SHPK së pari do ta humbas të drejtën e kontratës, që me të drejtë do të na takonte, bazuar në Nenin 6 Të Ligjit të Prokurimit Publik.*
- *Koha dhe shpenzimi të hollave për përgatitjen e tenderit (përgatitjen e koncorziumit dhe të ngjashme),*
- *Ka shkaktuar ngecje në proceset tjera të kompanisë,*

- *si ngecje në pjesëmarrjen e tenderëve tjerë*
- *si dhe humbjen e resurseve humane etj..*

*KËRKOJMË nga Autoriteti Kontraktues që lëndën TA KTHEJ NË RIVLERËSIM, dhe të na shpërblej me kontratë koncorsiumin tonë - P.M.N. shpk dhe PROing&Partrners shpk*

**10. Lista e dokumenteve (dëshmive) të bashkangjitura**

*Nëse aplikohet, bashkëngjitni Ankesës dokumentet e renditura më poshtë:*

- *B05 Njoftim për Kontratë (***16.10.2020***)*
- *Formulari i Korrigjimit* ***(19.10.2020)***
- *Dosja e Tenderit (***16.10.2020***)*
- *Proceseverbali i hapjes (***26.10.2020***)*
- *Vendimi i AK i datës (***13.11.2020***)*
- *Kërkesa për rishqyrtim* ***(16.11.2020)***
- *Vendimi për refuzim të kërkesës për rishqyrtim* ***(18.11.2020)***
- *Ankesa pranë OSHP-së më dt.* ***(27.11.2020)***
- *Vendimi i Panelit nr.1027-20* ***(28.12.2020)***
- *Kërkesa për rishqyrtim* ***(16.11.2020)***
- *Vendimi për refuzim të kërkesës për rishqyrtim* ***(18.11.2020)***
- *Ankesa pranë OSHP-së më dt.* ***(27.11.2020)***
- *Kërkesa për rishqyrtim* ***(09.02.2021)***
- *Vendimi për refuzim të kërkesës për rishqyrtim* ***(11.02.2021)***

****Sipas Nenit 111.2 të LPP, Parashtruesi i ankesës, origjinalin e ankesës do t'ia dorëzojë OSHP-së dhe njëkohësisht një kopje do t'ia dërgojë në mënyrën më të shpejtë të mundshme Autoritetit* Kontraktues.